



QKRMT Qendra Kosovare për Rehabilitimin
e të Mbijetuarve të Torturës
KRCT The Kosova Rehabilitation
Center for Torture Victims



VËSHTRIM MBI NDIKIMIN E QKRMT-SË | 2025

Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT) sjell ndryshime të prekshme për të mbijetuarit e torturës dhe të dhunës seksuale të luftës, duke kombinuar shërbimet e specializuara me avokimin strategjik. Në vitin 2025, QKRMT e shndërroi këtë mbështetje në rezultate konkrete për të mbijetuarit, institucionet dhe procesin e drejtësisë tranzicionale në Kosovë.



REZULTATET PËRMES NUMRAVE

- ✓ **604 të mbijetuar** kanë përfituar nga shërbime psikosociale, mjekësore dhe ligjore.
- ✓ **Janë ofruar 1485 shërbime individuale, grupe dhe familjare.**
- ✓ **38 fëmijë viktima të abuzimit seksual** kanë marrë mbështetje psikosociale dhe ligjore.

Fitore ligjore:

- Janë ngritur **12 aktakuza** dhe **4 raste** [2 në mungesë] kanë përfunduar me aktgjykime të formës së prerë, duke rezultuar në **3 dënime** për dhunë seksuale.
- Deri më tani, **gjithsej 58 vjet burgim** janë shqiptuar ndaj katër të pandehurve.
- Përmes përfaqësimit në gjykatë, QKRMT ka siguruar **njohje dhe kompensim** retroaktiv për të mbijetuarit, një rast është kompensuar me **24,000 €** pas 7 vjet pritje, dhe një tjetër me **13,000 €** pas 3 vjet pritje.
- Janë siguruar të drejta për **pension të dyfishtë** për **3 raste**, me një kompensim retroaktiv në vlerë prej **24,600 €**.
- ✓ **80 profesionistë** janë trajnuar në qasje të informuara nga trauma.
- ✓ **32 aktivitete të ndërgjegjësimit** kanë sfiduar stigmatizimin dhe heshtjen.



QKRMT dhe Feride Rushiti nominohen për Çmimin Nobel për Paqe 2025

Feride Rushiti dhe **Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës**, u nominuan për **Çmimin Nobel për Paqe 2025**, me propozim të deputetit suedez **Magnus Jakobsson**. Ky nominim vlerëson më shumë se dy dekada përkushtim ndaj të mbijetuarve të torturës dhe dhunës seksuale të luftës, dhe mbi të gjitha guximin e të mbijetuarve që i kanë dhënë drejtim dhe kuptim punës sonë.





2025 NË FOKUS

Hap vendimtar në reduktimin e stigmës: Zëri im, Forca ime

Në vitin 2025, me mbështetjen e QKRMT-së përmes **avokimit të përgjegjshëm dhe të udhëhequr nga vetë i mbijetuarit, Ramadan Nishori** u bë i mbijetuari i parë mashkull i dhunës seksuale të luftës në Kosovë që foli publikisht. Ky moment shënoi një pikë kthese të rëndësishme në njohjen e të mbijetuarve meshkuj, thyerjen e stigmatizimit, si dhe zgjerimin e kuptimit publik dhe institucional mbi dhunën seksuale të luftës.



Drejtësi për të mbijetuarit e dhunës seksuale të luftës

QKRMT ka luajtur rol udhëheqës në **avancimin e drejtësisë për të mbijetuarit e dhunës seksuale të luftës**. Që nga viti 2018, kemi avancuar drejtësinë përmes përfaqësimit në gjykatë, duke siguruar dënime, njohje të viktimave, kompensim retroaktiv dhe të drejtat për pension të dyfishtë.



Çmimin Ndërkombëtar për të Drejtat e Njeriut

Drejtorja e QKRMT-së, **Feride Rushiti**, u nderua nga Kolegji AAB me **Çmimin Ndërkombëtar për të Drejtat e Njeriut 2025**. Ky vlerësim u përket mbi të gjitha të mbijetuarve të dhunës seksuale të luftës dhe torturës, që thyen heshtjen dhe kërkuar drejtësi.



Përvjetori i QKRMT: 26 vjet Kujdes, Shpresë dhe Drejtësi

QKRMT shënoi **26 vjet përkushtim në rikthimin e dinjitetit**, mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe avancimin e drejtësisë për të mbijetuarit e dhunës seksuale të luftës në Kosovë. Ky përvjetor ishte një moment reflektimi dhe mirënjohjeje për **guximin e të mbijetuarve**, vuri në pah rëndësinë e **dokumentimit të së vërtetës** dhe nderoi ato/ata që patën forcën të thejnë heshtjen, duke u bërë burim shprese për të tjerët.





Dinjtet dhe fuqizim i të mbijetuarve: Dhoma e sigurt e inauguruar në Gjykatën Themelore të Prishtinës

'Dhoma e Sigurt' u ofron të mbijetuarve një mjedis të sigurt dhe mbështetës për përgatitje dhe dhënie të dëshmisë, duke ofruar privatësi, mbështetje psikologjike dhe ligjore, si dhe masa për mbrojtjen e dinjitetit të të mbijetuarve gjatë gjithë procedurave gjyqësore.



Çmimi Evropian i Vitit: Një vlerësim për guximin, dinjitetin dhe drejtësinë

Feride Rushiti, Drejtore Ekzekutive e QKRMt-së, u shpall Evropian i Vitit nga **Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë**. Ky vlerësim thekson përkushtimin afatgjatë të QKRMt-së për mbështetjen e të mbijetuarve dhe avancimin e të drejtave të njeriut. Çmimi u dedikohet mijëra të mbijetuarve, guximi i të cilëve ka formësuar misionin tonë.



Fokusi drejt së ardhmes – 2026

- ✓ Zgjerimi i mbështetjes psikosociale dhe ligjore për më shumë të mbijetuar.
- ✓ Forcimi i qasjes në reparacione dhe drejtësi përmes avokimit.
- ✓ Zgjerimi i mbështetjes për familjet, duke adresuar traumën ndërbrezore dhe ndikimin e saj afatgjatë.
- ✓ Përmirësimi i sistemeve të të dhënave për të matur rezultatet dhe ndikimin.

26+ vjet përkushtim i dëshmuar

Lidership i besueshëm në drejtësi dhe në rimëkëmbjen e të mbijetuarve